Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	**Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit dhe Teknologjisë së Drurit**
Programi:	**Arkitektura e Interierit dhe Dizajni i Mobilieve**
Titulli i lëndës:	**Menaxhimi i burimeve njerëzore**
Niveli:	**Bachelor**
Statusi lëndës:	**Obligative**
Viti i studimeve:	**III**
Numri i orëve në javë:	**3**
Vlera në kredi – ECTS:	**5**
Koha / lokacioni:	**USHAF**
Mësimëdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Tema kryesore që mbulon këtë modul janë si më poshtë: Prezentimi i Syllabusit, MBNJ, çelësi i suksesit në biznes; , Sjellja individuale & Mjedisi i organizatës, Ekipi menaxherial, Trajtimi i të punësuarve dhe Etika në biznes, Komunikimi, Intervista - Praktikë profesionale / Vizitë studimore, Planifikimi i BNJ dhe Zgjedhja e personelit, Bazat e motivimit , Menaxhimi i performances , Praktikë profesionale / Vizitë studimore, Pagat, Zhvillimi i Burimeve Njerëzore, Menaxhmenti i qëndrueshëm i burimeve njerëzore në konkurrencën globale
Qëllimet e lëndës:	Studentët të marrin njohuri të reja të natyrës teorike dhe praktike nga fusha e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore; Studentët të kuptojnë pse është e nevojshme menaxhimi i burimeve njerëzore : Studentët të fitojnë njohuritë për planifikimin, rekrutimin, seleksionimin, motivimin, komunikimin, zhvillimin, vlerësimin e performancës; Studentët të mund të zbatojnë në praktikë njohuritë e fituara përmes shembujve praktik etj.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të fitojnë: • Njohuri bazike për menaxhimin e burimeve njerëzore duke përfshirë Planifikimin, Organizimin, Staffingun, Drejtimin, Kontrollin dhe Koordinimin

	• Aftësi dhe Shkathtësi të aplikoj në praktik njohurit për menaxhimin profesional të burimeve njerëzore në organizatë • Kompetenca të kryejnë përshkrimin e vendit të punës për stafin në varësi, të kryej analiza për të identifikuar metodën për të stimuluar stafin në varësi për tu integruar në pune grupore si dhe të identifikoj vështirësitë eventuale dhe kohën kur stafi duhet të motivohet për punë. • Aftësi të kuptojnë se menaxhimi i burimeve njerëzore është një proces për sigurimin e njerëzve të duhur në vendin e duhur dhe në kohën e duhur.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	**Orë**	**Ditë/javë**	**Gjithsej**
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike	2	2	4
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume	2	1	2
Punim seminarik	2	3	6
Detyra të shtëpisë	1	3	3
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			30
Përgatitja përfundimtare për provim	6	4	24
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	4	4
Projektet, prezentimet ,etj	2	2	4
Totali			**127**

Metodologjia e mësimdhënies:	Mësimdhënia do të zhvillohet përmes ligjëratës, shembujve praktikë, interpretimeve individuale e grupore, punimit të seminareve, vlerësimeve periodike, etj. Të gjitha këto do të realizohet në aspektin teorik dhe praktik duke i prezantuar materialet në formën audio-vizuale përmes teknologjisë elektronike me programet e Windows Office. Në aspektin teorik do të ofrohen njohuri të përgjithshme shkencore, bazuar në literaturën

	bashkëkohore. Pjesa praktike kryesisht do të realizohet përmes shembujve konkret nga literatura dhe nga njohuritë praktike te ndërmarrjet prodhuese private e publike dhe te organizatat jofitim prurëse. Në këtë mënyrë do të synohet krijimi i raporteve ndër-vepruese profesor–student si dhe ai student-student.
Metodat e vlerësimit:	Prezenca 0-10 pikë Angazhimi në ligjërata dhe ushtrime 0-10 pikë Testi I 0-35 pikë Testi II 0-35 pikë Punimi seminarik 0-10 pikë Provimi 0-70 pikë Testet I dhe II janë teste me shkrim me ndarje proporcionale të pyetjeve sipas ligjëratave, ku do të jenë nga 10 pyetje, nga të cilat do të ketë pyetje të hapura, pyetje të mbyllura dhe gjysmë të hapura. Provimi ka 20 (18 +2) pyetje me ndarje proporcionale të pyetjeve sipas ligjëratave, nga të cilat do të ketë pyetje të hapura, pyetje të mbyllura dhe gjysmë të hapura. Vlerësimi bëhet për 18 pyetje, kurse dy pyetje shtesë janë mundësi për zëvendësim. Pikët nga prezenca, angazhimi dhe punimi seminarik barten.
Literatura	
Literatura bazë:	1. *Canco G., (2018), Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Tiranë,* 2. *Canco G., (2007), Menaxhimi i Burimeve Njerëzore, Zbatime praktike, Tiranë*
Literatura shtesë:	3. *Robbins S. P. & DeCenso D., (2012), Bazat e menaxhimit, Koncepte dhe aplikime themelore, Tiranë* 4. *Huf S., (2020), Personalmanagement, Springer Gabler, Stuttgart*
Plani i dizajnuar i studimeve:	
Java	**Ligjërata që do të zhvillohet**
Java e parë:	*Prezentimi i Syllabusit*
Java e dytë:	*MBNJ, çelësi i suksesit në biznes;*
Java e tretë:	*Sjellja individuale & Mjedisi i organizatës*
Java e katërt:	*Ekipi menaxherial, Trajtimi i të punësuarve dhe Etika në biznes*
Java e pestë:	*Komunikimi*

Java e gjashtë:	*Intervista - Praktikë profesionale / Vizitë studimore*
Java e shtatë:	*Testi 1*
Java e tetë:	*Planifikimi i BNJ dhe Zgjedhja e personelit*
Java e nëntë:	*Bazat e motivimit*
Java e dhjetë:	*Menaxhimi i performances*
Java e njëmbëdhjetë:	*Pagat*
Java e dymbëdhjetë:	*Praktikë profesionale / Vizitë studimore*
Java e trembëdhjetë:	*Zhvillimi i Burimeve Njerëzore*
Java e katërmbëdhjetë:	*Menaxhmenti i qëndrueshëm i burimeve njerëzore në konkurrencën globale*
Java e pesëmbëdhjetë:	*Testi 2*

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
• Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. • Studentët inkurajohen që të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. • Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve. • Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërate të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen. Studentët inkurajohen të përcjellin diskutimet në media dhe të hapin diskutime për to. • Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat studimore. Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në ligjërata. Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e indeksit në teste dhe provim. • Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet ti përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.